

# SKANER RRJETI I BESUESHËM E I FUQISHËM



## Skaner rrjeti i dedikuar

Canon imageFORMULA ScanFront 400 është skaneri optimal që ndihmon me njësimin e cikleve të punës me dokumente. Ndërfaqja e thjeshtë bën të mundur skanim të shpejtë dhe të lehtë në email, foldera rrjeti, FTP, memorie USB, faks ose printerë direkt nga ekrani TFT me prekje 10.1" (25.7 cm) i shpejtë dhe i shndritshëm - nuk ka nevojë për harduerë ose softuerë të tjerë.

## Ideal për çdo biznes

Madhësia e tij e përshtatshme për në tavolinë, ndërtimi elegant dhe punimi i heshtur e bëjnë perfekt për përdorim në punë administrative dhe në sportele përballë klientit në pika shitjeje, banka, qendra kujdesi shëndetësor dhe profesione ligjore. Bizneset e vogla mund të përfitojnë nga digjitalizimi i shpejtë i dokumenteve dhe ruajtja në një databazë qendrore. Një rrjet skanerësh ScanFront 400 mund të integrohet në infrastrukturën ekzistuese të korporatave të mëdha duke mundësuar skanim të decentralizuar.

## ScanFront 400

SHPEJTËSIA  
BARDHEZI DHE ME  
NGJYRA 45 PPM /  
90 IPM

VOLUMI I  
SUGJERUAR DITOR:  
6,000 SKANIME/DITË

VETËMBUSHËSJA E  
DOKUMENTEVE: 85  
FLETË

EKRAN ME PREKJE  
10.1"

# SKANER I FUQISHËM RRJETI I DEDIKUAR

## Rritje e produktivitetit

Skanoni më shumë dokumente me skanimin e shpejtë prej 45 faqesh në minutë plus një ADF të madh me 85 fletë. Canon provoi dhe testoi mekanizimin e furnizimit me dokumente dhe cilësinë e ndërtimit të fortë me kapacitet prej 6 000 skanimesh në ditë për të garantuar besueshmëri të pakrahasueshme. Sensorët ultrasonikë dallojnë menjëherë furnizimet dyshe ndërsa funksioni Double Feed Release (DFR) bën të mundur skanimin e lehtë të zarfeve dhe dokumenteve të palosura.

## Gamë e gjerë letrash

Bëjeni të lehtë skanimin e të gjitha llojeve të dokumenteve, që nga A4, A5 dhe kartëvizitat deri në rrotullat e gjata të dokumenteve (deri në 3 metra) dhe kartat plastike, pasaportat dhe dokumentet A3 (në metodën folio) - ideale për departamentet e burimeve njerëzore, hotelet dhe bankat. Pajisja dallon automatikisht madhësinë e letrës dhe bën rregullimin sipas nevojës.


## Personalizim dhe integrim

OS me bazë Linux dhe ScanFront 400 sjell fuqinë dhe elasticitetin për t'u integruar me punën tuaj me dokumentet. Krijoni dhe dërgoni skeda indeksi metadatash të personalizuar me çdo skanim, duke bërë të mundur klasifikim të thjeshtë të dokumenteve në sistemet e punës administrative. Integrorët e sistemit mund të përdorin aplikacionin e uebit Software Development Kit për të integruar personalizimet e tyre ose për të ndërtuar aplikacione të bëra me porosi për skanerin.



# SIGURI DHE FUNKSIONE TË AVANCUARA PËR MENAXHIMIN NGA PËRDORUESI

## ScanFront Administration Tool



| IP address / Device name | Last access time    | Status              | Details          | Open Web Menu |
|--------------------------|---------------------|---------------------|------------------|---------------|
| 192.168.159.102          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.103          | Not access yet      | Host Not Found      | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.104          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.105          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.106          | Not access yet      | Host Not Found      | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.107          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.108          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.109          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.110          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |
| 192.168.159.111          | 2016/01/08 14:47:53 | Connection Possible | Check Details... | Open Web Menu |

Softueri i mjetit të administrimit ju lejon që të menaxhoni shumë skanerë ScanFront në të njëjtën kohë. Mund të kontrolloni statusin aktual të skanerëve ScanFront në rrjet, të konfiguroni parametrat, të menaxhoni përdoruesit, të krijoni kopje rezervë si dhe të riktheni të dhënat e konfigurimit.

## Përdorim i sigurt

Siguria vjen si standarde: opsionet përfshijnë hyrje me fjalëkalim, dalje automatike dhe kërkesë për konfirmim adrese para dërgimit.




Konfigurimet dhe destinacionet e shpeshta të skanimit mund të ruhen si butona pune dhe t'u caktohen përdoruesve të caktuar duke bërë të mundur përdorimin e thjeshtë dhe të sigurt me një prekje me më pak gabime njerëzore. Administratorët mund të kontrollojnë nga larg përdoruesit e regjistruar dhe të përditësojnë firmuerin ose softuerin në disa pajisje njëkohësisht - duke pakësuar kostot IT.

- **Siguri për pajisjen:** pajisjen mund ta hapin vetëm përdoruesit e autorizuar, duke përdorur verifikim me ID dhe fjalëkalim, që mund të kontrollohet duke përdorur identifikimin tuaj në Active Directory ose LDAP. Një çidentifikim automatik ju jep mbrojtje të mëtejshme kundër aksesit të përdoruesve të paautorizuar në pajisje
- **Siguri për përdoruesit:** lejet për përdoruesit mund të caktohen individualisht, duke garantuar që përdoruesit që mund të hapin vetëm opsionet dhe funksionet e duhura ose të nevojshme të skanimit
- **Siguri për dokumentet:** dokumentet e skanuara, si p.sh. skedarët mund të dërgohen me shifrim PDF dhe mbrojtje me fjalëkalim, që të mund të kontrolloni aksesin për shikim, redaktim dhe printim. Për më tej, nuk ruhen kopje të dokumenteve të skanuara në pajisje.

# SKANIM I SHPEJTË, I QËNDRUESHËM DHE DIZAJN KOMPAKT





## Reduktoni kostot e IT me menaxhimin në distancë

ScanFront 400 konfigurohet e menaxhohet lehtë, duke ju ndihmuar të ulni shpenzimet e IT. Thjesht lidhni skanerin në rrjet pa qenë nevoja të instaloni programe serveri. Mund të përditësoni, rezervoni dhe riktheni pajisje të ndryshme nga distanca me një shfletues të thjeshtë interneti ose të kryeni përditësime të ndryshme duke përdorur ScanFront Admin Tool.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PRODUKTIN

|                                      |  |
|--------------------------------------|--|
| <b>Tipi</b>                          | Skaner dokumentesh rrjeti ADF  |
| <b>Njësia e sensorit të skanimit</b> | CMOS CIS 1 Line Sensor (x2)  |
| <b>Rezolucioni optik</b>             | 600 dpi  |
| <b>Burimi i dritës</b>               | LED RGB  |
| <b>Ana e skanimit</b>                | Në një anë / në dy anë   |
| <b>Ndërfaqja</b>                     | LAN: 10Base-T / 100Base-TX / 1000Base-T (fole RJ-45)<br>3x USB 2.0 (për memorie USB, tastierë, maus, etj.) |
| <b>Paneli i përdorimit</b>           | 10.1" (TFT-LCD Touch Panel (WSGVA 1024 x 600)  |
| <b>Ndarja e letrës</b>               | Ruli i frenimit  |
| <b>Cikili ditor i punës</b>          | Afro 6.000 skanime/ditë  |

### SPECIFIKIMET E SKANIMIT

|                                  |  |
|----------------------------------|--|
| <b>Shpejtësia në bardhë e zi</b> | 45 ppm / 90 ipm  |
| <b>Shpejtësia me ngjyra</b>      | 45 ppm / 90 ipm  |
| <b>Rezolucioni i skanimit</b>    | 100 x 100 dpi / 150 x 150 dpi / 200 x 200 dpi / 300 x 300 dpi / 400 x 400 dpi / 600 x 600 dpi  |
| <b>Modalitetet e skanimit</b>    | Bardhë e zi, Difuzion gabimesh, Përforsim teksti, Shkallë gri 256 nivele, Ngjyra 24-bit, Dallim automatik i ngjyrave   |
| <b>Veçoritë e skanimit</b>       | Zbulim ultrasonik i furnizimit dysh, Riprovim / rilëshim i furnizimit dysh, Pjerrësi, Metodë folio, Skanim i dokumenteve të gjata, Tejkallim i faqes bosh, Orientim automatik i dokumentit, Lëmim i sfondit, Reduktim i depërtimit, Heqje e hijes, Rrëzim / përforsim i ngjyrave TIFF, JPEG, PNG, PDF, PDF/A |
| <b>Dalja e skedarit</b>          |  |

### SPECIFIKIMET PËR DOKUMENTET

|                                    |  |
|------------------------------------|--|
| <b>Letra</b>                       | Gjerësia: 50 - 216mm<br>Gjatësia: 54 - 356mm<br>(3,048mm në metodën e dokumenteve të gjata)<br>Trashësia (veçimi ON): 27 - 209 g/m <sup>2</sup> (0.04 - 0.25 mm)<br>Trashësia (veçimi OFF): 27 - 255 g/m <sup>2</sup> (0.04 - 0.30 mm) |
| <b>Kartëvizitë</b>                 | Përmasat: 50x85 mm<br>Trashësia: deri 380g/m <sup>2</sup> (0.35 mm)  |
| <b>Kartë</b>                       | Madhësia: 54 x 86 mm (Standard ISO)<br>Trashësia: 1,4 mm<br>Vetëm mbushje horizontale, maks. 10 karta ose 1 me relief  |
| <b>Pasaportë</b>                   | Përdorni fletë opsionale mbajtëse pasaportë<br>Trashësia: deri në 6mm (përfshirë një fletë mbajtëse)   |
| <b>Kapaciteti i fletëmbajtëses</b> | 85 fletë   |

### VEÇORITË E RRJETIT

|                                 |  |
|---------------------------------|--|
| <b>Destinacionet e skanimit</b> | Skanim në Folder të ndarë<br>Skanim në Email<br>Skanim në FTP<br>Skanim në FAKS (përmes shërbimit të faksit me internet)<br>Skanim në printer (printim FTP)<br>Skanim për në memorie USB |
| <b>Protokollet</b>              | TCP/IP (IPv4), DNS, DHCP, SMB, NTP, HTTP, FTP, SFTP, Dërgim i sigurt (FTPS dhe SMTPS), WebDAV, LDAPS   |
| <b>Adresa IP</b>                | I marrë automatikisht (mbështetje DHCP) ose fiks   |
| <b>Mbështetja e direktorisë</b> | Direktori aktive (autentifikim NTLM)<br>OpenLDAP (autentifikim i thjeshtë)   |
| <b>PROGRAM</b>                  |  |
| <b>Vegla softuerike</b>         | ScanFront Administration Tool<br>Web Application Toolkit (SDK) <sup>[1]</sup>  |

### TIPARET FIZIKE

|  |  |
|--|--|
| <b>Përmasat (gj. x thell. x lart.)</b> | Sirtarët e mbyllur: 305 x 282 x 230 mm<br>Sirtarët e hapur: 305 x 629 x 366 mm                   |
| <b>Pesha</b>                           | Afro 4,5 kg  |
| <b>Kërkesat elektrike</b>              | AC100-240V (50/60Hz)   |
| <b>Konsumi elektrik</b>                | Skanim: 40 W e poshtë<br>Modaliteti pasiv: 2,0 W e poshtë<br>Kur është i fikur: 0,5 W ose më pak |
| <b>Ambienti i përdorimit</b>           | Temperatura: 10 - 32,5 °C<br>Lagështia: 20-80% relative  |
| <b>Standardet mjedisore</b>            | RoHS   |

### PJESËT E KONSUMIT DHE AKSESORËT

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Pjesët e konsumit</b> | Exchange Roller Kit (rul furnizimi dhe rul shtyrjeje),<br>Fletë mbajtëse (Pasaportë), Fletë mbajtëse (A4) |
|--------------------------|---|

### Shënimet në fund të faqes

<sup>[1]</sup> Ofrohet përmes Canon Business Solutions Developer Programme - [www.canon-europe.com/bsdp](http://www.canon-europe.com/bsdp)

Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit nga Canon përveç ku tregohet ndryshe. Objekt i ndryshimeve pa njoftim paraprak.

Vizitoni faqen e internetit të Canon për më shumë informacion.

### Sëti i zhvillimit programatik (SDK)

Setet dhe mjetet e zhvillimit programatik ofrohen përmes Canon Developer Programme. Për t'u regjistruar për programin:

- Vizitoni faqen e regjistrimit - <https://developers.canon-europe.com/developers/s/login/SelfRegister>
- Nëse keni ndonjë problem gjatë regjistrimit, ju lutemi të kontaktoni me administratorin e CDP në adresën [cdp-admin@canon-europe.com](mailto:cdp-admin@canon-europe.com)

Ofrohet SDK



**Canon**

Canon Electronics Inc.  
canon-elec.co.jp  
Canon Europe  
canon-europe.com  
Albanian edition  
© Canon Europa N.V., 2022